



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

---

Numri i lëndës: 2022:232418

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05426002

C.nr. 519/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Nehat Qelaj, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: 1. . P. si dhe 2. A. . që të dy mësimdhënës në fshatin D., Komuna e M., të cilët i përfaqëson avokati Zahir Hamza nga Prishtina, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim, të cilën e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj nga Malisheva, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë (shujtës), vlera objektit të kontestit 900.00 Euro, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, më datë 07.03.2024, merr këtë:

## A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT e bazuar kërkesëpadia e paditësve: 1. . P. si dhe 2. A. . që të dy mësimdhënës në fshatin D., Komuna e M., ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim, që paditësve t’iu kompensimin në emër të shpenzimeve të ushqimit (shujtës), në shumën e përgjithshme prej 900.00 Euro, për të dy paditëseve dhe atë:

- Paditësit A. P., shumën e përgjithshme prej 450.00 Euro, ku në emër të ushqimit (shujtës) në punë llogariten nga 2.00 Euro, për 225 ditë të vajtjes në punë, për periudhën prej datës 01.09.2021 e deri më datë 15.07.2022, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë data 08.08.2022, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

- Paditësit A. P., shumën e përgjithshme prej 450.00 Euro, ku në emër të ushqimit (shujtës) në punë llogariten nga 2.00 Euro, për 225 ditë të vajtjes në punë, për periudhën prej

datës 01.09.2021 e deri më datë 15.07.2022, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë data 08.08.2022, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim, që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditësve t’ua paguaj shumën prej 176.00 Euro, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësve: 1. A.P. si dhe 2. A. P. që të dy nga fshati D., Komuna e Malishevës, mbi shumën e gjykuar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi në shumë totale prej 255.00 Euro, sa i përket shpenzimeve të procedurës.

## A r s y e t i m

Paditësit: 1. . P. si dhe 2. A. . që të dy mësimdhënës në fshatin D., Komuna e M., në këtë gjykatë përmes të autorizuarit e tyre kanë ushtruar padi më datë 08.08.2022, kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë (shujtës), në shumën prej 900.00 Euro.

### *Pretendimet e palëve ndërgjyqëse.*

Paditësit më tej kanë theksuar se janë të punësuar tek e paditura në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “E.D.”, në fshatin D., Komuna e Malishevës, e të cilët i plotësojnë kushtet për kompensimin e ushqimit (shujtës) në punë. Duke shtuar se e paditura në bazë të Kontratës Kolektive të vitit 2021 nenit 35 par. 7 ka qenë e obliguar që paditësve t’ua paguaj shpenzimet e ushqimit (shujtës) në punë. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë në tërësi dhe ta detyrojë të paditurën në pagesën e shpenzimeve të ushqimit (shujtës) në punë në shumën e përgjithshme prej 900.00 Euro, si në vijim: Paditësit 1. A. P., shumën e përgjithshme prej 450.00 Euro, ku në emër të ushqimit (shujtës) në punë llogariten nga 2.00 Euro, për 225 ditë të vajtjes në punë, për periudhën prej datës 01.09.2021 e deri më datë 15.07.2022, si dhe paditësit 2. A. P., shumën e përgjithshme prej

450.00 Euro, ku në emër të ushqimit (shujtës) në punë llogariten nga 2.00 Euro, për 225 ditë të vajtjes në punë, për periudhën prej datës 01.09.2021 e deri më datë 15.07.2022, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë nga data 08.08.2022.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar, sipas tarifës së OAK-së, në vlerë të përgjithshme prej 431.00 Euro, dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 208.00 Euro, për seancë 202.80 Euro, si dhe për pagesën e taksës gjyqësore shumë prej 21.00 Euro.

E paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim, në përgjigjen në padi të datës 20.12.2023, ka theksuar se në këtë rast kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit pasi që paditësi ka kërkuar shujta nga viti 2021 – 2022 pasi që nuk ka qenë kontrata kolektive në fuqi e vitit 2017, po ashtu kontrata kolektive e arsimit ndërmjet SBASHK-ut si dhe MASHTI-t, është shkëputur nga kjo e fundit dhe tani nuk është në fuqi, pasi që nuk kanë pasur legjitimitet për ta nënshkruar këtë kontratë, po ashtu MAPL ka bërë njoftimin e kryetarëve të komunave më datë 22.11.2022, për shkëputjen e kësaj kontrate nga MASHT-imë mungesë të bazës ligjore pas që nuk ka qenë e buxhetuar nga MEF, po ashtu nga ditët e llogaritur nuk është zbatuar gjendja faktike pasi që nuk janë hequr ditët e pandemisë në vitin 2020/2021, ku dihet se pandemia ka filluar më datë 12.03.2020 dhe ka zgjatur deri më datë 30.06.2020, ashtu që në muajin mars i bije që 20 ditë pune më pak, prill i bije që 18 ditë pune më pak, maj i bije që 18 ditë pune më pak, si dhe qershor i bije që 21 ditë pune më pak, të gjitha këto në total 67 ditë. Prandaj, duke pasur parasysh që Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është më në fuqi, dhe në këtë çështje kontestuese nuk kanë legjitimitet të palës aktive në procedurë, dhe se këtë legjetimietë tani e ka MASHT, duke i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëseve si të pabazuar ose që kjo çështje kontestuese të zhvillohet ndaj Qeverisës së Republikës së Kosovës – MASHT.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përfaqësuesi i të paditurës nuk është deklaruar.

*Gjendja faktike e vërtetuar si dhe provat e administruara.*

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Vërtetimin për ditët e prezencës në punë të paditësit A.P. nr. proto: 01/629, të

datës 15.07.2022, si dhe Vërtetimin për ditët e prezencës në punë të paditëses A. P. nr. proto: 01/627, të datës 15.07.2022, që të dy të lëshuar nga SH.F.M.U “E.D.” në fshatin D., Komuna e Malishevës.

Gjykata konstaton se për palët ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësit kanë pasur të themeluara marrëdhënien e punës me të paditurën në nga SH.F.M.U “E.D.” në fshatin D., Komuna e Malishevës, kjo është vërtetuar në bazë të vërtetimeve të punës për mësimdhënëse, të lëshuar nga e paditura, respektivisht drejtori i saj A.P..

Kontestuese për palët ndërgjyqëse ka qenë fakti se a i takon paditësit e drejta e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit (shujtës).

Me shikimin në vërtetimin për ditët e prezencës në punë të paditësit A. P. nr. proto: 01/629, të datës 15.07.2022, të lëshuar nga SH.F.M.U “E. D.” në fshatin D., Komuna e Malishevës, gjykata vërtetoi faktin se për periudhën prej datës 01.09.2021 e deri më datë 15.07.2022 paditësi i lartcekur ka 225 ditë pune, e për të cilat nuk është kompensuar asnjëherë deri më tani nga e paditura.

Me shikimin në vërtetimin për ditët e prezencës në punë të paditëses A. P. nr. proto: 01/627, të datës 15.07.2022, të lëshuar nga SH.F.M.U “E. D.” në fshatin D., Komuna e Malishevës, gjykata vërtetoi faktin se për periudhën prej datës 01.09.2021 e deri më datë 15.07.2022 paditësi i lartcekur ka 225 ditë pune, e për të cilat nuk është kompensuar asnjëherë deri më tani nga e paditura.

*Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës.*

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 7, 8 nenit 147, lidhur me nenin 398 si dhe nenit 399 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim kryesor të çështjes ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Ligji nr. 03/L-212 i Punës, në nenin 90 par. 5 e përcakton se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*”. Ndërsa sipas dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017, por edhe të datës 22.01.2021, në mënyrë të njëjtë kanë paraparë në nenin 35 par. 7 se: “*Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore*”. Sipas vlerësimit të gjykatës, këto dispozita gjykata janë bazë e mjaftueshme ligjore prej të cilave rrjedh e drejta e paditësit për kompensimin e kërkesës së tij për të cilën gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të lartcekura dhe faktit se Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-u, janë nënshkruese të Kontratës Kolektive të potencuar, gjykata vjen në përfundim se kjo kontratë kolektive prodhon efekt juridik për të gjithë të punësuarit në sektorin e arsimit që janë anëtarë të SBASHK-ut. Në këtë kuptim e paditura ka legjitimitet të plotë pasiv në procedurë.

Gjykata vendosi ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e detyruar të paditurën që paditësve t’ua paguaj shpenzimet e ushqimit (shujtës) në punë për faktin se të gjitha këto janë të bazuara në provat të cilat janë elaboruar më lartë dhe duke i shumëzuar ditët e punës së vijueshmërisë së tyre sipas kërkesës me dy (2) euro për ushqim në ditë, dalin vlerat të cilat janë aprovuar për secilin paditës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e që bazohen në prova të qarta, të cilave gjykata iu fali besimin e plotë. Kështu, në emër të ushqimit (shujtës) në shumën e përgjithshme prej 900.00 Euro, si në vijim: paditësit 1. A. P., shumën e përgjithshme prej 450.00 Euro, ku në emër të ushqimit (shujtës) në punë llogariten nga 2.00 Euro, për 225 ditë të vajtjes në punë ( $225 * 2 = 450$ ), për periudhën prej datës 01.09.2021 e deri më datë 15.07.2022, si dhe paditësit 2. A.P., shumën e përgjithshme prej 450.00 Euro, ku në emër të ushqimit (shujtës) në punë llogariten nga 2.00 Euro, për 225 ditë të vajtjes në punë ( $225 * 2 = 450$ ), për periudhën prej datës 01.09.2021 e deri më datë 15.07.2022, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë nga data 08.08.2022, e për të cilat gjykata ka bërë llogaritjet konform dispozitave ligjore dhe kontratës kolektive.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit duke refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëseve mbi shumën e gjykuar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sa i përket shpenzimeve të procedurës dhe atë në shumë prej 255.00 Euro, kjo pasi

që sipas rregullores për tarifat e avokatëve nr. tarifor 6 përpilimi i parashtrësive në procedurë civile dhe procedura tjera, ku përcaktohet se: *“padia apo kërkesat tjera te kontestet me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10.000 Euro, për paditësin/të paditurin e dytë është paraparë shuma prej 156.00 Euro”*, për çka ka vendosur si në pikën II dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke aprovuar shumën 156.00 Euro, ndërsa përfaqësuesi i autorizuar në padi i ka kërkuar shumën 202.80 Euro për seancë, që në këtë rast është e pabazë pasi që nuk është mbajtur asnjë seancë, dhe nuk i është njohur vlera mbi shumën 156.00 Euro, si shpenzim ku i është refuzuar shuma e zbritur nga vlera e kërkuar prej 255.00 Euro, përkatësisht diferenca (*duke llogaritur 431.00 Euro të kërkuara – 255.00 € të refuzuara pjesa e padisë si dhe për seancën që nuk është mbajtur = 156 Euro të aprovuara*), këtë e bazojë gjykata edhe në konkluzionet për unifikimin e praktikës gjyqësore të nxjerr nga Gjykata e Apelit e Kosovës, mbajtur më data 16 – 17 mars si dhe 26 – 27 qershor 2023, i cili konkludon se parashtrësat të cilat nuk janë në kuptim të nenit 99 të LPK-së, nenit 6 par. 1 të OAK-së, si dhe nenit 2 par. 4 të UA nr. 01/2017 të datës 15.03.2017 për unifikimin e taksave gjyqësore, parashtruesi nuk ka të drejtë në kompensimin të shpenzimeve për këto parashtrësia, mbi këtë bazë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë e përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Ndërsa, gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, për pjesën e refuzuar është bazuar në dispozitën e nenit 399 par. 1 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*.

Kështu që bazuar në dispozitat e këtij neni gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadija e paditësve ishte qartazi e themeltë, ka bazë në dispozitat e Ligjit nr.03/L-212 të Punës dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.01B-2056 e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.01B-105 e datës 22.01.2021, ndërsa shuma e kompensimit bazohet në provat që gjenden në shkresat e lëndës. Ndërsa lidhur me pjesën që është refuzuar gjykata ka zbatuar nenit 87 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, ku parashihet se: *“Të*

*gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.*

Gjykata analizoi edhe pretendimet e të paditurës, ku ka theksuar se në këtë rast kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit pasi që paditësi ka kërkuar shujta nga viti 2021-22 pasi që nuk ka qenë kontrata kolektive në fuqi e vitit 2017, po ashtu kontrata kolektive e arsimit ndërmjet SBASHK-ut si dhe MASHTI-t, është shkëputur nga kjo e fundit dhe tani nuk është në fuqi, pasi që nuk kanë pasur legjitimitet për ta nënshkruar këtë kontratë, po ashtu MAPL ka bërë njoftimin e kryetarëve të komunave më datë 22.11.2022, për shkëputjen e kësaj kontrate nga MASHT-imë mungesë të bazës ligjore pas që nuk ka qenë e buxhetuar nga MEF, po ashtu nga ditët e llogaritur nuk është zbatuar gjendja faktike pasi që nuk janë hequr ditët e pandemisë, por që këto pretendime nuk qëndrojnë dhe nuk i ka mbështetur me asnjë provë të vetme, ashtu që erdhi në përfundim se këto pretendime janë vetëm deklarative e të pambështetshme dhe se nuk kanë përmbushur kërkesat ligjore, të cilat do të kishin impakt që gjykata të vendos ndryshe nga ajo që ka vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimeve të palës paditëse se Kontrata Kolektive nuk është e vlefshme, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë nr. 01B-105 e datës 22.01.2021 në periudhën kontestuese ishte në fuqi sepse sipas nenit 48 të kësaj kontrate parashihet që: *“Kjo Kontratë Kolektive hynë në fuqi pas nënshkrimit të dy palëve kontraktuese”*, ndërsa pas datës 21.11.2022, ku është shkëputur kontrata kolektive e arsimit në mënyrë të njëanshme e të cilën edhe vetë e paditura e ofruar si provë ndërsa nga paditësi nuk ka kërkuar ndonjë kompensim përtej kësaj datë, siç është cekur më lartë.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë më datë 08.08.2022, bazuar edhe në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës, me nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Prandaj, duke u bazuar në të lartcekurat, si dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par. 5 e Ligjit të Punës, nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.01B-105 e datës 22.01.2021, nenit 382 të LMD-së, por edhe të nenit 398 dhe nenit 399 par. 1 lidhur me nenin 147 par. 1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që e paditura t'ia kompensojë paditësve shumën si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e që përfshijnë: për përpilim të padisë shumën prej 156.00 Euro, si dhe taksën gjyqësore në shumë prej 20.00 Euro, në shumën e përgjithshme prej 176.00 Euro, sipas TA (Tarifës së Avokatëve të Kosovës).

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA MALISHEVË,**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil,

C.nr. 519/2022, më datë 07.03.2024.

Gj y q t a r i

Nehat Qelaj

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës, në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplar të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.